# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-452467**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dyshohet se është larguar drejt Shqipërisë: Autoritetet greke në kërkim të Alket Rizait pas thyerjes së lejes nga burgu |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/dyshohet-se-eshte-larguar-drejt-shqiperise-autoritetet-greke-ne-kerkim-t-i586711` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 13:44:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 15:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1069b73ed977fea543e26213bf1d3ad7b59a38f43586fef9deb9093e7c317753` |
| TEKSTI | `d2fa12046365f5dc711456551d21c3750dc7c382e96ec4e8bb7998a8df537426` |
| PAMJA | `8af6fba1d55df09ab8623b67eed4ae70352757253c5a946076012647813ab510` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c5394e9d10bcc1528c9a4c393d133ea0b939038a170661fb708c2f3f7b7105ee` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c5394e9d10bcc1528c9a4c393d133ea0b939038a170661fb708c2f3f7b7105ee`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Dyshohet se është larguar drejt Shqipërisë: Autoritetet greke në kërkim të Alket Rizait pas thyerjes së lejes nga burgu

TemA

17 Shtator 2026, 17:50Kronika TEMA




ATHINË – Autoritetet policore greke kanë nisur një megaoperacion për lokalizimin dhe kapjen e Alket Rizait, i cili nuk është rikthyer në burgun e Domokos pas përfundimit të lejes së tij shpërblyese. Rizai duhej të paraqitej në qeli të hënën, më 14 shtator, në orën 08:00, por ka thyer urdhrin e lejes. Hetimet e deritanishme e vendosin gjurmën e tij të fundit në Greqinë e Veriut, çka ka ngritur dyshime se ai mund të ketë kaluar ilegalisht kufirin drejt Shqipërisë, ndonëse kjo mbetet ende një pistë e pakonfirmuar zyrtarisht.

Arratsja e tij lidhet edhe me një ngjarje të rëndë kriminale të regjistruar më 13 shtator, vetëm një ditë para afatit të kthimit në burg. Rizai dyshohet se është i përfshirë në një konflikt me armë zjarri ku mbetën të plagosur dy persona. Pas ngjarjes, ai është larguar në drejtim të paditur, duke shtyrë policinë greke ta shpallë zyrtarisht në kërkim ndërkombëtar. Kjo ishte leja e 17-të që ai përfitonte nga viti 2021, ndërsa në 16 rastet e mëparshme i përmbahej rregullisht afateve.

Alket Rizai është një nga emrat më të njohur të botës kriminologjike në shtetin fqinj:

Viti 2003: U dyshua për vrasjen e biznesmenit grek Thanasis Koropiotis.

Viti 2006: Realizoi arratisjen e bujshme nga burgu i Korydallos me helikopter bashkë me Vasilis Paleokostas. Po atë vit, ekzekutoi në Peristeri Konstantinos Koutelieris dhe Ioannis Katsios me urdhër të mafiozit Vasilis Stefanakos.

Viti 2009: U arratis për herë të dytë me helikopter nga burgu i Korydallos.

Viti 2013: Tentoi të arratisej nga burgu i Malandrinos duke marrë peng pesë gardianë.

Viti 2021: U ndalua gjatë një kontrolli rutine në mjet me persona të rrezikshëm teksa ndodhej po ashtu me leje nga burgu.

Hetimet për kapjen e tij po vijojnë në bashkëpunim edhe me agjencitë e tjera ligjzbatuese.

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Alarmi i rremë për bombë në shkollën "Emin Duraku," "detyrim paraqitje" për Mandi Jataganin: Do ta bëj sërish nëse...]

15:10 Kronika

VIDEO/ Arrestohet 34-vjeçari në Tiranë, dyshohet se kreu 16 vjedhje në lokale, kamerat kapin lëvizjet e të riut

14:50 Kronika

Arrestime për pronat në Fier/ Dy ish-drejtorë të Kadastrës në pranga, ndërtuesi përfitoi 1143 ha

14:30 Kronika


[Plagosën me thikë dy vëllezër, arrestohen në flagrancë 3 persona]

13:50 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.